



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 812 Prot.

Tiranë, më 27.07 2016

VENDIM Nr. 84, datë 22.07.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 10 të datës 22.07.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor për *Pikat Stacionare me vendndodhje në Selcë-Tamarë, Shkodër; Fushë- Arrëz, Shkodër; Planbardhë, Dibër; Kurbnesh, Lezhë; Krujë, Tiranë; Gjuzej, Elbasan; Gramsh, Elbasan; Ardenicë, Fier; Bogova, Berat; Poliçan, Berat; Çorovodë, Berat; Pepellash, Korçë; Leskovik, Korçë; Përmet Gjirokastrë; Tepelenë, Gjirokastrë; Çarshovë, Gjirokastrë; Haderaj, Vlorë; Ksamil, Vlorë*, në kuadër të projektit "Ndërtimi i rrjeteve numerike të transmetimit DVB-T2 të RTSH-së"-subjekti RTSH, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor për *Pikat Stacionare me vendndodhje në Selcë-Tamarë, Shkodër; Fushë- Arrëz, Shkodër; Planbardhë, Dibër; Kurbnesh, Lezhë; Krujë, Tiranë; Gjuzej, Elbasan; Gramsh, Elbasan; Ardenicë, Fier; Bogova, Berat; Poliçan, Berat; Çorovodë, Berat; Pepellash, Korçë; Leskovik, Korçë; Përmet Gjirokastrë; Tepelenë, Gjirokastrë; Çarshovë, Gjirokastrë; Haderaj, Vlorë; Ksamil, Vlorë*, në kuadër të projektit "Ndërtimi i rrjeteve numerike të transmetimit DVB-T2 të RTSH-së"-subjekti RTSH, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik duke përcaktuar:
 - Pozicioni i antenës në fshatin Hadëraj të Vlorës, përkon me vendndodhjen e fortifikimit antik të shekullit III para Kr. të "Qytezës së Hadërajt", në rakordim të plotë me ASHA të spostohet ndërtimi i saj në një pozicion tjetër të përshtashëm, që të mos dëmtojë fortifikimin e sipërpërmendur.
 - Në vendin e parashikuar për ndërtimin e antenës në zonën e fshatit Gjuzej të Elbasanit, para fillimit të punimeve, të kryhet nga ASHA një sondazh arkeologjik, për të cilin investitori duhet të kryejë pagesën sipas tarifave të miratuara nga Ministria e Financës.

2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare përkatëse dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO